



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

10535
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 26.05.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacioni “Për një ndryshim në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një ndryshim në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegimi

ZV.KRYETAR

Alban Preka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

10534
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 26.05.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2025

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit 7961, datë 12.07.1995 ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’ të ndryshuar; ligjit nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar; Vendimit nr.520, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, shkresë nr. 16211/1 prot., datë 03.12.2024 të Ministrisë së Financave me lëndë: “Mbi kërkesën për shtesë fondi për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në buxhetin 2025”, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, pika 1 germa g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, shtesë në numrin e punonjësve të MZSH, sipas tabelës nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjësit shtesë të strukturës së Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër përballohen nga buxheti i bashkisë – Transferta sektoriale për vitin 2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ZV/KRYETAR

Alban



Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Enxheta

Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Enxheta

Drejtorja Juridike

Enxheta

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve mbështetëse

Enxheta

Drejtorja e Mbrojtjes nga Zjarri dhe
Shpëtimit

Agim

N. Z. Genti

Ishte
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1039	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1059	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1052	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1,072	20

K R Y E T A R
Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligji nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Vendimi nr.520, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027”, i ndryshuar; shkresë nr. 16211/1 prot., datë 03.12.2024 të Ministrisë së Financave me lëndë: “Mbi kërkesën për shtesë fondi për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në buxhetin 2025”, Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit total të punonjësve tek Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër nga 42 aktualisht në 55 punonjës.

Pra në total një rritje prej 13 punonjësish.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër, mbështetet në plotësimin e nevojave me efektivë zjarrëfikës që ka struktura aktuale e sektorit të ndërhyrjeve operacionale (shuarjes së zjarreve) pranë kësaj drejtorie.

Aktualisht sektori i ndërhyrjeve operacionale (shuarjes së zjarreve) përbëhet prej 34-punonjës zjarrëfikës, nga ku 4 prej tyre janë punonjës informacioni dhe si rrjedhojë numri i punonjësve që marrin pjesë në operacione ndërhyrje (shuarje zjarri) mbetet 30-punonjës zjarrëfikës faktik. Në zbatim të ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” theksohet se për sigurimin e këtij funksioni duhet për çdo 1500-2000 banorë një punonjës Zjarrfikës. Duke parë edhe disa faktore të tjerë specifik për Bashkinë Shkodër, si më poshtë vijon:

- Shtrirja shumë e madhe territoriale e Bashkisë Shkodër, me një largësi nga stacioni aktual deri në 80km, për të shkuar në objektin e rrezikuar
- Situata e zjarreve është bërë problematike, si pasojë edhe e ngrohjes globale.
- Nevoja për të siguruar pushimet vjetore të punonjësve dhe pushime të tjera, sipas VKM nr.203 datë 10.04.2019.
- Nevoja për të mbuluar një shërbim shtesë gjatë sezonit të Plazhit në Velipojë
- Nevoja më e rëndësishme për tu gjendur sa me afër vatrës së zjarreve.

Kërkojmë:

-Një shtesë numri të punonjësve zjarrfikës niveli bazë prej 12-punonjës Zjarrfikës për ndërhyrje operationale (shuarje zjarri).

- Një shtesë numri të punonjësve zjarrfikës niveli mesëm 1 punonjës me detyrë Shef Stacioni pasi si rezultat i faktorëve të sipërcituar është e nevojshme marrja e masave për ngritjen edhe të një stacioni shtesë tek zona e kryqëzimit të harku i Bërdicës pasi është një pozicion ku ndërhyrja mundet të jetë shumë shpejt afër rrezikut të zjarreve dhe situatave të tjera shpëtuese, duke mbuluar të gjithë zonën e nënshkodrës si dhe Njësinë Ana e Malit deri në Muriqan dhe zonën e Shirokë, Zogaj.

Ngritja e këtij stacioni në këtë zonë duke qenë shumë afër rrugës nacionale që lidhë Shkodrën me Njësitë e Qytetet e tjera ndihmon në bashkëpunimin e ndërsjellë të operationeve të shpëtimit mes strukturave të zjarrfikësve me rrethet dhe qytetet e tjera të vendit.

Lidhur me këtë situatë kemi njoftuar dhe Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave me shkresën Nr.26779 Prot, Dt. 19.11.2024 dhe jemi njoftuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Financave Vendore me shkresën Prot. 16211/1 dt. 03.12.2024 se në Buxhetin e Vitit 2025 janë plotësuar nevojat financiare per standartin minimal ligjor per funksionimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (një zjarrfikës për 1500 -2000 banorë) duke akorduar fondin per Bashkinë Shkodër me anë të transfertës sektoriale për vitin 2025 për 13 punonjes shtesë të shërbimit zjarrfikës për arritjen e standartit.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar”;

Duke ju falenderuar!

**KRYETAR
Benet BECI**

Me vendim delegimi

ZV.KRYETAR

Alban Preka



IME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA

DATE 27.12.24

NR. NGA: 27682



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 162111/1
prot.

Tiranë, më 3.12.2024

Lënda: Mbi kërkesën për shtesë fondi për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në buxhetin 2025

BASHKISË SHKODËR

Shkodër

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 26779 Prot., datë 19.11.2024, me lëndë "Kërkojmë informacion", ju informojmë si më poshtë vijon:

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, lidhur me vlerësimin e nevojës financiare për plotësimin e standardit të shërbimit zjarrfikës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financës për vitin 2025 ka plotësuar standardin minimal ligjor për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (një zjarrfikës për 1500 – 2000 banorë) për 15 bashki. Konkretisht, për bashkinë Shkodër në transfertën sektoriale për vitin 2025 për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi është shtuar fondi për financimin e 13 punonjësve shtesë për arritjen e standardit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja

Besmir Beja



LISTËPAGESA MUJORE E PAGAVE

Institucioni : Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimim

Periudha :

Numri: 13

Data:

NR. Emër Mbiemër	Emërtesa e pozicionit sipas strukturës së miratuar	Kategoria / Klasa / Funkzioni / Grada	Ditë pune (përfshirë dhe ditët e pushimit vijtor)	Paga bazë për klasë/gradë /shtesë pozicioni/paga fikse për funksion/paga fikse për veçanta	Shtesë page për natyrë të veçantë pune/kushte pune/kushte të veçanta	Shtesë page për turne të dyta të treta normale të punës	Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës	BRUTO					NETO		
								Sigurimi i detyrueshëm shoqëror	Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor	Sigurimi Supplementar	Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në % mbi Pagën Bruto	Shuma e ndalesave		PAGA BRUTO MUJORE	PAGA NETO MUJORE
1-	2-	3-	4-	5-	7-	12-	16-	17-	21-	24-	25-	26-	27-	31-	32-
1. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
2. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
3. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
4. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
5. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
6. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
7. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
8. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
9. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
10. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
11. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
12. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
13. ASIS/ZJARRFIKES	Pol.zjifiks shpëtues,luftues	Komisar/zjafk	22	60,000	7,000	14,170	9,646	90,816	8,627	1,544	4,541	7,906	22,618	68,198	
Totali për punonjësit e miratuar në organikë				780,000	91,000	184,210	125,394	1,180,604	112,151	20,072	59,033	102,778	294,034	886,570	
Totali për të gjithë punonjësit				780,000	91,000	184,210	125,394	1,180,604	112,151	20,072	59,033	102,778	294,034	886,570	



Paga 6 Muaj	7,083,624
Sigurime shoqërore shëndetësore	1,182,965
TOTAL PAGA + SIG	8,266,589

Shenim :

